



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR  
MË 21 MAJ 2008**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE  
21. MAJA 2008. GODINE**

**Maj – Maja  
2008**

## **R e n d i i d i t ë s**

### **1. Shqyrtimi i dytë i Grupit të tretë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:**

- 1.1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës,
- 1.2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë,
- 1.3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
- 1.4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror,
- 1.5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për azil, dhe
- 1.6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.

## **D n e v n i r e d:**

### **2. Drugo razmatranje treće grupe nacrtu zakona iz Predloga Martti Ahtisaarija, po posebnom postupku:**

- 1.1. Drugo razmatranje Nacrt zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo,
- 1.2. Drugo razmatranje Nacrt zakona o Obaveštajnoj agenciji Kosova,
- 1.3. Drugo razmatranje Nacrt zakona o Agenciji za privatizaciju,
- 1.4. Drugo razmatranje Nacrt zakona o integrisanom upravljanju i kontroli državne granice,
- 1.5. Drugo razmatranje Nacrt zakona o azilu, i
- 1.6. Drugo razmatranje Nacrt zakona o službenim praznicima u Republici Kosova.

## **A g e n d a:**

### **1. Second reading of the third group of the Draft Laws from the Martti Ahtisaari's**

#### **Proposal, based on the Special procedure:**

- 1.1. Second reading of the Draft Law on Education in the Municipalities of the Republic of Kosovo,
- 1.2. Second reading of the Draft Law on the Kosovo Intelligence Agency,
- 1.3. Second reading of the Draft Law on the Kosovo Privatization Agency,
- 1.4. Second reading of the Draft Law on Integrated Management and Control of the State Border,
- 1.5. Second reading of the Draft Law on Asylum, and
- 1.6. Second reading of the Draft Law on Official Holidays in Republic of Kosovo.

## TRANSKRIPT

### NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 21 MAJ 2008

Seanca plenare ia filloi punës në orën 10,00.

Seancën plenare e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 101 deputetë.

Rendin e ditës, me rekomandimet e Grupit ad-hoc, i keni përpara.

Ne, në mbledhjen e Kryesisë, me shefat e grupeve parlamentare, u dakorduam që pika e gjashtë e rendit të ditës të shtyhet.

Kryesia, në konsultim me shefat e grupeve parlamentare, propozon që Komisionit ad-hoc t'i jepet kohë shtesë për hartimin e rekomandimeve për Projektligjin 6.

Komisioni ad-hoc do të punojë nesër më 22. 5. 2008, kurse seanca plenare lidhur me Projektligjin 6 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, mbahet më 23 maj , në orën 10.

Për këtë, kërkoj ta bëjmë një votim formal me ngritje të dorës nga deputetët e Kuvendit.

Kush është “për”? Faleminderit!

A ka kush “kundër”? 1.

A ka abstenime? Faleminderit!

Me shumicën e votave të deputetëve, konstatoj se pika e gjashtë mbetet që Komisioni ad-hoc të punojë nesër dhe seanca do të mbahet pasnesër, në orën 10,00.

Ju faleminderit!

Që në fillim ju njoftoj se në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me të, sipas procedurës së veçantë të datës 15 shkurt 2008, në seancën e sotme plenare do të procedohet me leximin e dytë të projektligjeve të miratuara dje më 20 maj 2008 në leximin e parë.

Ia fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Komisioni Ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj zotin Lutfi Hazirin, që në emër të Komisionit ad-hoc të arsyetojë Raportin me rekomandime.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuar Kryesi, Kryeministër, anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në emër të Komisionit ad-hoc, në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kosovës, datë 15 shkurt 2008, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhe 21 maj 2008, anëtarët e Komisionit shqyrtuan projektligjet e Grupit të tretë nga Propozimi i zotit Marti Ahtisari, sipas propozimit të paraqitur nga Kryesia dhe Kuvendit i paraqet këtë raport pune.

**- Projektligji për arsim në komunat e Republikës së Kosovës.**

Komisioni shqyrtoi Projektligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës dhe njëzëri vendosi t'i rekomandojë Kuvendit ta miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara si vijon:

- Amendamenti 1, që ka të bëjë me preambulën dhe adaptimin, sipas Kushtetutës;
- Amendamenti 2, që ka të bëjë me pjesën përmbyllëse të nenit 17.

Deputetë të nderuar, meqë këto amendamente i keni para vetes, nuk shoh të arsyeshme t'i lexoj më tutje.

**- Projektligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë**

(Ndërhyrje e deputetit)

KRYETARI: Ju lutem, për çdo ligj, një nga një, duhet të ketë referim. Do të thotë, ju vetëm i referoni rekomandimet e Komisionit, për çdo ligj veç e veç. Faleminderit!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, Kryetar!

KRYETARI: Sipas mocionit të 15 shkurtit 2008, të drejtë për të marrë fjalën kanë shefat e grupeve parlamentare nga 5 minuta.

Tani për tani, shoh se asnjëri nga shefat, nuk është paraqitur për fjalë, prandaj vazhdojmë me procedimin e mëtutjeshëm.

Kalojmë në votimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni ad-hoc, sipas radhës së paraqitur në raport.

Amendamenti 1.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Ju njoftoj se në sallë janë 104 deputetë.

“Për” kanë votuar 87, 3 “kundër”, 5 abstenime dhe konstatoj se u miratua amendamenti 1.

Pyes deputetët a ka ndokush që nuk e ka kartelën me vete?

Vazhdojmë me amendamentin 2.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 86 vota “për”, 3 “kundër” dhe 5 abstenime miratohet amendamenti 2.

Tani votojmë ligjin në tërësi.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votimin e tekstit të Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tash:

Në sallë janë prezent 110 deputetë, 83 kanë votuar “për”, 3 “kundër” dhe 14 abstenime. Ju faleminderit!

Konstatoj se Kuvendi miratoi Ligjin për arsimin në komuna në Republikën e Kosovës.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

#### **- Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë**

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj zotin Lutfi Haziri që në emër të Komisionit ad-hoc të arsyetojë Raportin me rekomandime, nëse e sheh të arsyeshme, natyrisht.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

#### **- Projektligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë**

Komisioni e shqyrtoi Projektligjin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe njëzëri vendosi t’i rekomandojë Kuvendit ta miratojë Projektligjin me 6 amendamente, të paraqitura para jush:

Në nenin 8.2; 8.4; 9.4; 24 dhe 45, që nuk janë shumë substanciale, nuk e ndryshojnë, por ne kemi parë se janë të arsyeshme, sepse këto amendamente janë të domosdoshme, në mënyrë që ligji të plotësohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Kalojmë në votim për miratim të amendamenteve të propozuara nga Komisioni ad-hoc, sipas radhës së paraqitur në raport.

Të paraqitur për fjalë nga grupet parlamentare nuk ka, prandaj shkojmë në votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 89 vota “për”, 3 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 91 vota “për”, 3 “kundër” dhe 5 abstenime miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 90 vota “për”, 3 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Po, por tash, kemi hyrë në procedurë të votimit! Urdhëroni! Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti Kryetar.

Tek amendamentin numër 4 është problemi se këtë tekst, siç është shqip, nuk e marr vesh, sigurisht, është një pjesë e fjalisë, këtu si shkruhet, është shumë e paqartë: “pa marrë parasysh përkatësinë politike dhe bëhet”. Domethënë...

KRYETARI: Kjo fshihet, është shumë e qartë! Merre lexoje ligjin dhe e sheh.

Kalojmë në votim. Lus regjinë dhe deputetët le të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 80 vota “për”, 3 “kundër” dhe 7 abstenime miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 86 vota “për”, 3 “kundër” dhe 5 abstenime miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 87 vota “për”, 3 “kundër” dhe 3 abstenime miratohet amendamenti 6.

Tani, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim të tekstit të Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tash:

Konstatohet se me 92 vota “për”, 6 “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

Slllobodan, tani jemi në procedurë të votimit dhe do të vazhdojmë me votim. Faleminderit!

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës:

#### **- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj Lutfi Hazirin që në emër të Komisionit ad-hoc ta arsyetojë Raportin me rekomandime, nëse e shih të arsyeshme. Nëse s’e merr fjalën, atëherë po vazhdojmë.

Të drejtë për ta marrë fjalën kanë shefat e grupeve parlamentare, por ata nuk janë paraqitur për fjalë dhe kalojmë në votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 79 vota “për”, 5 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 79 vota “për”, 3 “kundër” dhe 7 abstenime miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, 3 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për ta votuar tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tash:

Konstatohet se me 75 vota “për”, 7 “kundër” dhe 10 abstenime Kuvendi miratoi Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në radhë është pika e katërt:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.**

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj zotin Lutfi Haziri që në emër të Komisionit ad-hoc ta arsyetojë Raportin me rekomandimet, nëse e sheh të arsyeshme.

Nga shefat e grupeve parlamentare nuk ka të paraqitur për fjalë.

Atëherë, kalojmë në votim të amendamenteve.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 88 vota “për”, 4 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 81 vota “për”, 4 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim të tekstit të Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tash:

Konstatohet se me 91 vota “për”, 4 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet Ligji për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

Në radhë është pika e pestë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për azil.**

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit u është shpërndarë deputetëve.



Komisioni ad-hoc ka rekomanduar miratimin e Projektligjit pa ndryshime.

Kalojmë në votim të miratimit të Projektligjit pa ndryshime.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 87 vota “për”, 6 “kundër” dhe 7 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për azil.

Me kësaj seancë e deklaroj të mbyllur.

Mirë u pafshim të premten, në orën 10.

Përgatiti:

**Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës**